

ANKIMIMI

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e vet, si Agjencia e Pagesave, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, si dhe sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar.

AZHBR është e organizuar në formën e një personi juridik publik në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

AZHBR është Institucioni, i cili rezervon të drejtën për vendimmarrje në rastet e ankimimit nga subjektet e interesuara.

Lidhur me ankesat për veprimin /mosveprimin apo për aktet të tjera administrative, procedura e ndjekur për ankimimin është si më poshtë:

1. Ankesat e aplikanteve për skualifikim/refuzim i drejtohen AZHBR në formë shkresore në adresën postare “AZHBR, Rruga Muhamet Gjolleasha, nr. 56, Tiranë”;
2. Ankesa pasi protokollohet, shqyrtohet nga Drejtoria Juridike, sipas përcaktimeve të Manualit të Procedurave të kësaj drejtorie;
3. Vendimi për pranimin apo refuzimin e ankimimit i drejtohet aplikantit brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, brenda 30 ditëve, referuar Nenit 132 të KPA;
4. Në rast se çështja është komplekse dhe kërkohet më shumë kohë për vendimmarrje, zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar, sipas Nenit 92 të KPA, pra 60 dite.
5. Pas marrjes së vendimit në rastet e refuzimit të ankimimit, aplikantit i rezervohet e drejta për ankim në Gjykatën Administrative të Shkalles së Parë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Nenin 18 të Ligjit 49/2012 për “Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative”;
6. Sipas Ligjit 49/2012 për “Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative”, shkallet e ankimimit ezaurohen vetëm nga Gjykatat e Republikës së Shqipërisë dhe nga asnjë gjykatë tjetër;

7. Bashkëlidhur çdo njoftimi për skualifikim, do te gjeni formatin standard te ankimimit (bashkëlidhur link), i cili duhet te plotësohet vetëm me shkrim, në cdo fushë te përcaktuar, të jetë i firmosur dhe të dorëzohet dorazi ose me postë, ne zyrën qendrore të AZHBR, me adresë AZHBR, Rruga Muhamet Gjollësja, nr. 56, Tirane. Në rast se formulari i ankimit nuk do të përmbushë kriteret kryesore te ankimit administrativ sipas Nenit 131 te KPA, nuk do të merret parasysh dhe do t'i kthehet ankimesit për plotësim.